



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 26.5.2022

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 26.5.2022, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 241, datë 26.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Irena Gjoka

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues, në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 28.5.2020, është njoftuar vendimi nr. 241, datë 26.2.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Irena Gjoka, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, sot Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të vendimit nr. 241, datë 26.2.2020, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar të drejtën e ankimit, pasi ka vlerësuar se ky vendim është i cenushtëm në tërësinë e tij. Si rrjedhojë, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik çmon se juridiksioni kontrollues dhe rivlerësues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (*në vijim referuar si Kolegji*), do të duhet të ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

Duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 241/2020, të Komisionit, mbështetur dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, para këtij trupi gjykues parashtrohen për shqyrtim, çështje si më poshtë vijojnë.

## I. Vlerësimi mbi pasuritë e subjektit të rivlerësimit

1. Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Gjoka, në Deklaratën “Vetting” dhe ato të dala gjatë hetimit administrativ të Komisionit (të trajtuara në ankim), rezultojnë si vijon: (1) “Apartament me sip. 71 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “\*\*\* \*\*”, Tiranë, pjesa takuese 100% në pronësi të subjektit; (2) “Apartament me sip. 62,65 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Patos, Fier, pjesa takuese ¼ në bashkëpronësi me prindërit dhe të vëllain. Pasuri të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit në Deklaratën “Vetting” dhe ato të dala gjatë hetimit administrativ rezultojnë si vijon: (3) “Apartament me sip. 66 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “\*\*\* \*\*”, Tiranë, pjesa takuese 100%; (4) Dy garazhe me sipërfaqe 14 m<sup>2</sup> secili, ndodhur në rrugën “\*\*\* \*\*”, Tiranë, pjesa takuese 100%; (5) Automjet tip “Mercedes Benz”, modeli B180, blerë në vitin 2014, për vlerën 6.557 euro, pjesa takuese 100%; (6) Automjet tip “Mercedes Benz”, modeli ML 270, blerë në vitin 2007 dhe shitur në vitin 2016, blerë në shumën 15.000 euro dhe shitur 900.000 lekë, pjesa takuese 100%.

1.1 Në analizë të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, hetimit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni, Komisioneri Publik, ndryshe nga arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit për kriterin e pasurisë, konstaton se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, që në kuptim dhe zbatim të nenit D, paragrafi 3 i aneksit të Kushtetutës, ta bënte atë subjekt të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe, për pasojë, të sillte konfirmimin në detyrë të tij, lidhur me çështjet në vijim:

### 2. *Për pasurinë nr. 1, “Apartament me sip. 71 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “\*\*\* \*\*”, Tiranë*

2.1 *Në D-Vett.*, subjekti deklaron: “Apartament banimi me sip. 71 m<sup>2</sup>”, rruga “\*\*\* \*\*”, Tiranë. *Vlera: 45.885 euro. Pjesa takuese: 100% në pronësi të subjektit. Burimi i krijimit: (i) kursime nga të ardhurat nga paga ndër vite; (ii) hua në shumën 2.000.000 lekë nga të tretët.*

2.2 *Në DV-2005*, subjekti deklaron: Blerje “Apartament banimi”, me sipërfaqe ndërtimore 80,5 m<sup>2</sup>, Tiranë, me kontratë sipërmarrje në datën \*\*.10.2005, për vlerën 45.885 euro, pjesa takuese 100% në pronësi të subjektit. Në deklarimin e këtij viti, subjekti ka deklaruar të shlyer tërësisht vlerën e apartamentit prej 45.885 euro dhe si burim i krijimit të pasurisë deklarohet: (i) Tërheqje depozite, nga Banka \*\*\*, në shumën 93.000 lekë; (ii) Tërheqje depozite nga \*\*\* Bank, në shumën 800.000 lekë; (iii) 15.000 euro kursime të vitit 2005; (iv) Tërheqje dhe mbyllje depozite në Bankën \*\*\* \*\*, pjesa që zotëron në shumën 4.000 USD. Në rubrikën: “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, subjekti ka deklaruar: “*Detyrim për blerjen e apartamentit, ndaj vëllait \*\*\* \*\*, shuma totale e detyrimit të pashlyer 20.000 euro*”.

2.3 Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes me nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.10.2005 dhe kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë \*\*.2.2007<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. është në cilësinë e palës shitëse dhe Irena Maneku (Gjoka) në cilësinë e palës blerëse.

2.4 Referuar kontratës së sipërmarrjes me nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.10.2005, përcaktohet se çmimi total i apartamentit është caktuar 45.885 euro, shumë të cilën palët deklarojnë se e kanë likuiduar totalisht me nënshkrimin e kësaj kontrate sipërmarrje.

2.5 Lidhur me burimin e deklaruar: (i) kursime nga të ardhurat nga paga ndër vite, nga hetimi administrativ i Komisioni, ka rezultuar si vijon:

2.5.1 Në lidhje me: (i) **Tërheqje depozite, Banka \*\*\*, në shumën 93.000 lekë,** \*\*\* Bank (ish-Banka \*\*\*) nuk konfirmon llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit<sup>2</sup>.

2.5.2 Në lidhje me: (ii) **Tërheqje depozite nga \*\*\* Bank, në shumën 800.000 lekë,** \*\*\* Bank<sup>3</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2001-2005, ka pasur llogari bankare pranë kësaj banke në monedha të ndryshme (Lekë, Chf dhe USD).

2.5.2.1 Nga verifikimi i llogarisë në monedhën lekë pranë kësaj banke, rezulton se: (i) deri në datën \*\*.12.2003, shuma e depozituar në llogarinë e subjektit ka qenë në vlerën 800.000 lekë; (ii) gjatë vitit 2004 janë depozituar në *cash* dy shuma nga 200.000 lekë, respektivisht në shkurt 2004 dhe në maj 2004, dhe deri në datë \*\* dhjetor 2004, subjekti ka kryer tri tërheqje *cash*, për një total prej 1.254.484 lekë; (iii) në datën \*\*.9.2005, në këtë llogari është depozituar *cash* shuma prej 1.700.000 lekë, e cila është tërhequr po *cash* në datën \*\*.10.2005.

2.5.2.2 Për sa i përket burimit të këtyre depozitave, në përgjigje të pyetësorëve dhe shpjegimeve pas rezultateve të hetimit, datë 17.2.2020, subjekti ka deklaruar: “...Në vitin 2003, kam depozituar shumën 800.000 lekë, të cilat i kam vendosur në depozite me afat. Pas lëvizjeve në llogari me të ardhurat nga paga ime (2 depozitime nga 200.000 lekë në shkurt dhe në maj të vitit 2004), kjo llogari pas maturimit ka arritur shumën 1.254.484 lekë. Në datën \*\* dhjetor 2004 e kam mbyllur këtë depozitë me afat, duke tërhequr *cash* shumën e mbetur në të. Kjo shumë është tërhequr me qëllim pagesën e këstit për blerjen e apartamentit, por për vonesa në ndërtim të ndërtuesit kjo shumë është likuiduar vetëm në tetor të vitit 2005”.

2.5.2.3 Në lidhje me mosdeklarimin e *cash-it* në vitin 2004, në shumën 1.254.484 lekë, në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar: “...Ka qenë një interpretim i gabuar i ligjit nga ana ime në vitin 2004, që, gabimisht, nuk kam deklaruar shtesën në shumën 454.484 lekë, pasi unë mendoja për sa kohë kisha deklaruar në vitin 2003 shumën 800.000 lekë dhe duke marrë në konsideratë faktin se në vitin 2004 kisha kryer transaksione bankare të depozitave në bankë, si dhe tërheqjen e shumës 1.254.484 lekë, e kam marrë të mirëqenë që, për sa kohë ishin veprime bankare, ato kishin lënë gjurmë dhe unë nuk kisha gjykuar se duhet të deklarohet shtesën në shumën 454.484 lekë, me burim të ardhurash kursimet nga paga. Sjell në vëmendje se kanë qenë fillesat e deklarimit, viti 2003 dhe 2004...”.

<sup>2</sup> Në përgjigjen e saj, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.2.2019, \*\*\* Bank (ish-Banka \*\*\*).

<sup>3</sup> Në përgjigjen e saj, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.3.2019.

- 2.5.2.4 Komisioni, në përfundim, ka arsyetuar se<sup>4</sup>: [...] *Llogaria bankare në të cilën është tërhequr shuma 454.484 lekë, është deklaruar në DP/2003, gjithashtu edhe si burim për blerjen e apartamentit në DP/2005. Subjekti ka kryer tërheqjen e kësaj shume në fund të vitit 2004 dhe e ka rikthyer sërish në bankë në datë \*\*.9.2005, duke shtuar dhe kursimet e vitit 2005 ...Komisioni krijon bindjen e mbështetur në prova se mosdeklarimi i shtesës së të ardhurave në shumën 454.484 lekë në DV-2004 nuk përbën mungesë të burimeve financiare për blerjen e apartamentit [...].*
- 2.5.3 Në lidhje me burimin e deklaruar (iii) **15.000 euro kursime të vitit 2005**, sikundër trajtuar gjerësisht në ankim, deklaramet e subjektit në procesverbalin e datës \*\* tetor 2014, mbajtur në ILDKPKI, deklaramet e saj në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, të Komisionit, datë 4.12.2019, dhe ato në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, janë kontradiktore<sup>5</sup>, konstatuar edhe nga vetë Komisioni.
- 2.5.3.1 Komisioni, në përfundim, pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, ka arsyetuar se<sup>6</sup>: “[...] *Subjekti në kohë të ndryshme ka deklaruar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie në mënyrë të ndryshme, por që këto deklarime nuk cenojnë thelbin e burimit të pasurisë së saj, i cili është të ardhurat nga paga e subjektit... Mospërputhja midis deklarameteve të subjektit nuk ka ardhur si pasojë e qëllimit të saj për të fshehur apo deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, por, siç rezulton, ajo është përpjekur për të detajuar burimin e kësaj pasurie. Nga analiza financiare konstatohet se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie, për rrjedhojë, nuk ngrihen dyshime, si dhe nuk provohet se subjekti ka pasur për qëllim të deklarojë në mënyrë të pasaktë burimin e kësaj pasurie”. Në vijim, Komisioni arrin në konkluzionin: “...Subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri, si dhe burimin e ligjshëm të saj në D-Vett. [...]”.*
- 2.5.4 Në lidhje me burimin e deklaruar: (iv) **Tërheqje dhe mbyllje depozite në Bankën \*\*\***, për pjesën që zotëron subjekti në shumën 4.000 USD. Nga verifikimi i akteve kanë rezultuar mospërputhje në deklarime mbi burimin e krijimit të kësaj depozite dhe pjesës takuese të subjektit në këtë depozitë, sikundër trajtuar gjerësisht në ankim. Deklaramet e subjektit në DV-2004, mbi burimin dhe kontributin në këtë depozitë, shpjegimet në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit dhe shpjegimet e dhëna pas rezultateve të hetimit, janë kontradiktore, konstatuar edhe nga vetë Komisioni.
- 2.5.5 Komisioni, në përfundim, ka arsyetuar se<sup>7</sup>: “[...] *Subjekti së bashku me familjen e saj të origjinës kanë pasur mundësi për të krijuar depozitën në shumën 23.000 USD, si në rast se kontributi i subjektit konsiderohet 4.000 USD, ashtu dhe në rastin kur kontributi i subjektit do të konsiderohet 19.000 USD. ...Mospërputhjet e konstatuara në deklarametin e subjektit gjatë hetimit do të konsiderohen si pasaktësi, por këto pasaktësi nuk mund të përbëjnë*

<sup>4</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f. 9, prg. 24.7.5).

<sup>5</sup> Referohuni prg. 19.15, 19.16, 19.17, f. 8 e Ankimit të Komisionerit Publik.

<sup>6</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f. 7).

<sup>7</sup> Referohuni vendimit të KPK-së, f.11.

*shkak për shkarkim, për sa kohë nga analiza financiare provohet mundësia e subjektit dhe familjes së saj të origjinës për krijimin e depozitës në shumën 23.000 USD [...]*”.

2.5.6 Në lidhje me burimin e deklaruar: (v) **Hua nga të tretët në shumën 2.000.000 lekë:**

2.5.7 Subjekti i rivlerësimit, për të provuar aftësinë huadhënëse të personit tjetër të lidhur (vëllait), i ka paraqitur Komisionit si prova shkresore: (i) dokumentacion nga organet tatimore greke, që vërteton të ardhurat e ligjshme të huadhënësit dhe bashkëshortes së tij, në periudhën 2001-2005, shoqëruar me vulë apostile; (ii) raport vlerësimi nga vlerësuesi \*\*\*.\*\*\*, të datës \*\*.12.2019, për të ardhurat nga ullahtat e z. \*\*\*.\*\*\*; (iii) deklarata të thjeshta pa datë, të shtetasve \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\*, si përfaqësues ligjor i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., të z. \*\*\*.\*\*\*, si përfaqësues ligjor i subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k.; (iv) tetë mandate pagese, të lëshuara (2011-2013) nga subjekti “\*\*\*\*” sh.p.k.

2.5.8 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, të datës 4.12.2019, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “...përveç të ardhurave më sipër nga punësimi në shtetin grek, im vëlla, \*\*\*.\*\*\*, ka përfituar tokë bujqësore, ullahte... Duke filluar nga viti 1993, ai ka poseduar dhe gëzuar këtë pasuri dhe ka siguruar të ardhura nga shfrytëzimi i saj... Sipas raportit të vlerësimit, datë \*\*.12.2019, përparitur nga eksperte e licencuar, rezulton se kjo pasuri, ndër vite, ka sjellë të ardhura të konsiderueshme, të cilat deri në vitin 2005 (që është edhe viti i dhënies së huas) përlllogaritet në shumën 4.157.550 lekë”.

2.5.9 Komisioni, pasi vlerësoi dokumentacionin e administruar dhe kreu analizën financiare, ka konkluduar se z. \*\*\*.\*\*\* (vëllai i subjektit), ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas<sup>8</sup>.

2.6 Në përfundim për pasurinë nr. 1, Komisioni ka arsyetuar se:<sup>9</sup> [...] subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri, si dhe burimin e ligjshëm të saj në Deklaratën “Vetting”. Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie, për rrjedhojë, nuk ngrihen dyshime, si dhe nuk provohet se subjekti ka pasur për qëllim të deklarojë në mënyrë të pasaktë burimin e kësaj pasurie. Në aneksin D të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 nuk parashikohen si shkak për shkarkim mospërputhjet në deklarime të subjektit në deklaratat periodike, të cilat nuk kanë pasur për qëllim fshehje ose paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurisë [...].

2.7 **Komisioneri Publik**, në vlerësim të akteve në dosje dhe provave të paraqitura nga subjekti, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit në trajtimin e rasteve të ngjashme, vlerëson se konkluzioni i mësipërm i Komisionit nuk mbështetet në gjendjen që janë aktet, duke analizuar më poshtë secilin burim të deklaruar për blerjen e pasurisë nr. 1:

2.7.1 *Lidhur me burimin: (i) Tërheqje depozite në \*\*\* Bank*, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursimet e poseduara në *cash* në DV-2004 dhe, si rrjedhojë, nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme burimi i shumës 1.700.000 lekë, i deklaruar si pagesë për blerjen e pasurisë nr. 1.

<sup>8</sup> Referohuni prg. 24.9.9, f. 13, të vendimit të Komisionit.

<sup>9</sup> Referohuni vendimit të KPK-së, f. 7, prg. 24.6.6.

- 2.7.1.1 Komisioneri Publik çmon se, referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, zyrtarët deklarues detyrohen të deklarojnë, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]. Sipas kësaj dispozite, përcaktohet detyrimi i subjekteve deklaruese për të pasqyruar çdo ndryshim të interesave private në çdo deklaram periodik. Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë, duke parashikuar që këto deklarata përbëjnë dokumente zyrtare dhe subjekti duhet të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre sipas formularit të deklarimit të pasurisë, i miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së. Forma e deklarimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por si një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar.
- 2.7.1.2 Në kuptim të sa më sipër dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>10</sup>, Komisioneri Publik vlerëson se, në funksion të kontrollit të pasurisë, kursimet në *cash* jashtë sistemit bankar duhet të përllogariten sipas deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratat e interesave private sipas viteve përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.
- 2.7.2 *Lidhur me burimin: (ii) 15.000 euro kursime të vitit 2005*, Komisionerit Publik, bazuar në deklaramet kontradiktore të subjektit, sikundër trajtuar gjerësisht në paragrafët 19.15 - 19.17, i rezulton se: (i) Në D-Vett., burimi i pasurisë nr.1 nuk është deklaruar saktësisht dhe plotësisht, pasi nuk ka deklaruar shumën prej 15.000 euro; (ii) Në analizë të burimit të deklaruar (15.000 euro *kursime nga pagat e subjektit për vitin 2005*) rezulton se të ardhurat nga paga e subjektit,<sup>11</sup> deri në momentin e pagesës së kryer nga subjekti, datë \*\*.10.2005, nuk mbulojnë kursimin e deklaruar në shumën 15.000 euro.
- 2.7.3 *Lidhur me burimin: (iii) Tërheqje dhe mbyllje depozite në Bankën \*\*\* \*\*\*,* marrë në konsideratë faktin se \*\*\* \*\* Bank<sup>12</sup> ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur edhe një llogari në monedhën USD pranë kësaj banke dhe, nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie, konstatohet se veprimi i parë lidhur me shumën 23.000 USD mban datën \*\*.4.2002<sup>13</sup>, në vlerësimin e Komisionerit Publik, analiza financiare mbi mundësitë e subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj depozite *duhej të ishte shtrirë fillimisht deri në datën e veprimit të parë (çeljes së saj)*. Në vijim të këtij arsyetimi, rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit deri në datën \*\*.4.2002 (në shumën 2.448.511 lekë<sup>14</sup>) janë

---

<sup>10</sup> Vendimet e Kolegjit dhe (JR) nr. 27/2020 dhe (JR) 13/2021.

<sup>11</sup> Të ardhurat e subjektit janar - tetor 2005 janë në shumën rreth 685.000 lekë.

<sup>12</sup> Në shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*.11.2019.

<sup>13</sup> Në vijim, kjo shumë është shtuar nga interesat bankare deri në momentin e tërheqjes, në vitin 2005.

<sup>14</sup> Të ardhurat nga pagat e subjektit sipas konfirmimeve të institucionit përgjegjës për periudhën 1993 - prill 2002 dhe të ardhurat nga interesat e depozitave bankare pranë \*\*\* Bank deri në këtë datë.

ndjeshëm më të ulëta se *kursimet* në emër të subjektit të rivlerësimit në sistemin bankar (në shumën 4.343.097 lekë<sup>15</sup>).

2.7.3.1 Pamjaftueshmëri financiare e burimeve të deklaruara konstatohet edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, mbi ekonominë e përbashkët familjare, nga ku rezulton se vetëm shuma e investimeve në pasuri të paluajtshme dhe kursime të depozituara në sistemin bankar deri në prill 2002 (pa llogaritur shpenzime minimale jetese për një familje me 4 persona, për periudhën 1993-2002) është në shumën 6.143.097 lekë, konsideruar ndjeshëm më e lartë se të ardhurat e dokumentuara<sup>16</sup>.

2.7.3.2 Nisur nga arsyetimi i vendimit, edhe pse nuk rezulton që Komisioni të ketë kualifikuar ligjërisht prindërit z. \*\*\*.\*\*\* dhe znj. \*\*\*.\*\*\*, si person tjetër të lidhur,<sup>17</sup> duket se në analizën financiare të Komisionit janë konsideruar si të ardhura të ligjshme të gjitha të ardhurat e pretenduara nga subjekti që rrjedhin nga ekonomia e përbashkët familjare, përfshirë këtu edhe të ardhurat e deklaruara të përfituara nga shfrytëzimi i ullinjve të babait të subjektit, z. \*\*\*.\*\*\* për periudhën 1994-2005, mbështetur në akt-ekspertimi privat dhe në *deklarata të thjeshta, pa datë, të disa shtetasve*<sup>18</sup>.

2.7.3.3 Komisioneri Publik vlerëson se aktet e mësipërme, të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, mbeten vetëm në kuadër të një deklarimi, por të pambështetura në asnjë burim prove nga ato që parashikon neni 49 i ligjit nr. 84/2016, referuar burimeve të provave, që mund të provojnë krijimin apo gjenerimin e të ardhurave, në kuptim të këtij procesi.

2.7.3.4 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>19</sup>, konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar masën e të ardhurave të pretenduara të realizuara, nuk mund të konsiderohet si dokumentacion provues i ligjshmërisë së burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, pasi nuk provon kushtet e përcaktuara në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

2.7.4 *Lidhur me burimin: (iv) **Hua nga të tretët në shumën 2.000.000 lekë***, Komisioneri Publik vlerëson se të ardhurat e dokumentuara nga emigracioni i familjes së huadhënësit, \*\*\*.\*\*\*, për periudhën deri në vitin 2005, në shumën 29.613 euro, janë të mjaftueshme vetëm për mbulimin e shpenzimeve të jetesës në shtetin grek, për një familje me 3 anëtarë<sup>20</sup>. Mbi

<sup>15</sup> Kundërvlera në lekë e depozitës 23.000 USD, e konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë në datë \*\*/4/2002, në vlerën 143.15, si dhe kundërvlerat e depozitave të subjektit të rivlerësimit aktive në dollarë, pranë \*\*\* Bank, të çelura gjatë vitit 2001, konvertuar në kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2001.

<sup>16</sup> Deri në prill 2002, *të ardhurat e ligjshme familjare* janë në shumën totale 3.974.289 lekë. Ndërkohë, përveç kursimeve në sistemin bankar të subjektit, në vlerën 4.343.097 lekë, nga aktet në dosjen gjyqësore provohet edhe blerja e apartamentit në Fier nga vëllai i subjektit, \*\*\*.\*\*\*, në datën \*\*/1/2001, për vlerën 1.800.000 lekë, vlerë e cila duket se nuk është e përfshirë në zërin "shpenzime", në analizën e Komisionit. Theksojmë se ky apartament nga vetë subjekti është deklaruar si adresë banimi në DV-2003, DV-2004, DV-2005.

<sup>17</sup> Në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>18</sup> Dy deklarata të shtetasve \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\*.

<sup>19</sup> Referuar vendimeve të Kolegjit, (JR) nr. 9/2020; (JR) nr. 26/2020 dhe (JR) nr.18/2021.

<sup>20</sup> Sipas të dhënave zyrtare të publikuara në: <https://ec.europa.eu/eurostat>.

përfshirjen në analizën financiare të personit tjetër të lidhur, të të ardhurave nga shfrytëzimi i ullinjve për periudhën 1994-2005, mbështetur vetëm në akt-ekspertimi privat dhe deklaratatë të thjeshta, pa datë, të disa shtetasve<sup>21</sup>, marrë në konsideratë dhe jurisprudencën e Kolegjit<sup>22</sup>, Komisioneri Publik vlerëson se këto akte nuk provojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, duke mos u konsideruar kështu si të ardhura të ligjshme në kuptim të këtij neni.

2.8 Në përfundim të analizës së provave/akteve në dosje të Komisionit për pasurinë “Apartament 71 m<sup>2</sup>”, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, për sa trajtuar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm, duke rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme të të ardhurave që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë së pasurisë nr. 1.

### **3. Pasuria nr. 2, “Apartament me sip. 62,65 m<sup>2</sup>”, ndodhur në Patos, Fier**

3.1 *Kjo pasuri nuk rezultoi e deklaruar në D-Vett., ndërsa në DV-2003, subjekti ka deklaruar: “Apartament banimi 2+1”, me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup>, në adresën: “\*\*\*\*”, Fier. Nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP-ja gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se subjekti ka në bashkëpronësi këtë pasuri me familjarët e saj (1/4 pjesë secili). Fituar me kontratën e privatizimit datë \*\*.12.1992.*

3.2 Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit mbi mosdeklarimin e kësaj pasurie në D -Vett., Komisioni, ka konkluduar se<sup>23</sup>: [...] *nga të gjitha rrethanat e faktit del se kemi të bëjmë me një harresë të paqëllimshme, që nuk ka sjellë fshehje të pasurisë, për aq kohë sa evidentohet në regjistrat hipotekore, si dhe origjina e kësaj pasurie është nga privatizimi. Duke qenë se ky apartament është në pronësi të përbashkët midis subjektit dhe familjes të saj të origjinës, nuk evidentohen të dhëna që të lindin dyshime për fshehje apo veprime korruptive në blerje të kësaj pasurie. Pavarësisht kësaj, Komisioni vlerëson se mbetet fakt që subjekti nuk e ka deklaruar këtë bashkëpronësi në Deklaratën “Vetting”, duke e vënë subjektin në kushtet e pasaktësisë në deklarim, por që nuk ka pasur për qëllim fshehjen e pasurisë, duke mos përbërë në këtë mënyrë shkak për shkarkimin e subjektit [...].*

3.3 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti ka pasur detyrimin ta deklarojë këtë pasuri dhe ajo nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, në kuptim të nenit D, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë.

<sup>21</sup> Tri deklaratatë të shtetasve \*\*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\*, si përfaqësues ligjor i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., të z. \*\*\*.\*\*\*, si përfaqësues ligjor i subjektit “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe tetë mandate pagese, të lëshuara (2011-2013) nga subjekti “\*\*\*\*” sh.p.k.

<sup>22</sup> Shihni vendimin e KPA-së (JR) nr. 9/2020; (JR) nr. 26/2020 dhe (JR) nr.18/2021.

<sup>23</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f.15).



#### 4. Pasuria nr. 3, “Apartament me sipërfaqe 66 m<sup>2</sup>”, Tiranë

4.1 Në D-Vett., bashkëshorti i subjektit deklaron si pasuri veçmas të regjistruara në emrin e tij: “Apartament me sipërfaqe 66 m<sup>2</sup>”, adresa rruga “\*\*\*\* \*\*\*\*”, Tiranë. Blerë në vitin 2001, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë \*\*.12.2001, çmimi i blerjes 1.400.000 lekë. *Pjesa zotëruese: 100%. Burimi i krijimit të pasurisë: (i) Të ardhura nga paga, të kursyera gjatë viteve; si dhe (ii) të ardhura të krijuara nga qiraja e objektit lokal Bar-Bilardo, Fier.*

4.2 Origjina<sup>24</sup> e kësaj pasurie rrjedh nga kontrata e shitblerjes<sup>25</sup> nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.12.2001, përkundrejt çmimit 1.400.000 lekë dhe kontrata e sipërmarrjes me nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.10.2000, për vlerën 26.400 USD.

4.3 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit<sup>26</sup>, ndër të tjera, rezultojnë dhe disa mandate arkëtimi me numra rendorë, të vulosura dhe të nënshkruara nga administratori i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. \*\*\*\*.\*\*\*, referuar të cilave z. \*\*\*\*.\*\*\* ka paguar për këtë pasuri shumën totale prej 26.767 USD<sup>27</sup>.

4.4 Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, në përgjigjet e Pyetësorit nr.1, datë 31.10.2019, lidhur me mospërputhjet e konstatuara në çmimin dhe burimin e deklaruar për blerjen e apartamentit, Komisioni ka vlerësuar se:<sup>28</sup> [...] *Nga analiza financiare konstatohet se bashkëshorti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Në përfundim nuk rezultojnë dyshime në lidhje me këtë pasuri të bashkëshortit të subjektit [...].*

4.5 Komisioneri Publik çmon se ky vlerësim i Komisionit nuk është në përputhje me gjendjen që janë aktet. Për sa i përket burimit të deklaruar, të ardhura nga qiraja e godinës 2-katëshe në Fier për vitet 1996-2001, rezulton se detyrimet tatimore mbi të ardhurat e pretenduara të përfituara nga z. \*\*\*\*.\*\*\* (bashkëshorti), janë paguar nga ky i fundit vetëm gjatë hetimit administrativ<sup>29</sup> dhe, si të tilla, këto të ardhura, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>30</sup>, nuk plotësojnë kriteret për t’u konsideruar të ligjshme.

4.5.1 Komisioneri Publik çmon se pagimi në dhjetor të vitit 2019, i detyrimeve tatimore mbi të ardhurat personale të krijuara në vitet 1996-2001, duket se është kryer vetëm për t’i shërbyer procesit të rivlerësimit, në kushtet e shmangies së pagimit të tij në kohën kur ky detyrim kishte lindur.

4.5.2 Për më tepër, nga hetimi i kryer nga Komisioni pranë organeve tatimore<sup>31</sup>, rezulton se vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e qiramarrësve, nuk kanë ushtruar aktivitet privat për periudhën 1996-2000, si dhe nuk provohet kryerja e pagesës së qirasë nëpërmjet sistemit

<sup>24</sup> ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.3.2019, ka konfirmuar se në emër të z. \*\*\*\*.\*\*\* (bashkëshorti i subjektit) është e regjistruar pasuria “Apartament me sipërfaqe 66 m<sup>2</sup>”, nr. \*\*\* hipotekor, datë \*\*.12.2001, z. k. \*\*\*.

<sup>25</sup> Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse dhe z. \*\*\*\*.\*\*\* (bashkëshorti i subjektit), në cilësinë e palës blerëse.

<sup>26</sup> Nga dokumentacioni i përcjellë Komisionit nga ILDKPKI, me shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*.2.2019.

<sup>27</sup> i) Mandat arkëtimi nr. \*\*, datë \*\*.10.2000, për shumën 10.500 USD (kësti i parë); ii) mandat arkëtimi nr. \*\*, datë \*\*.7.2001, për shumën 4.860 USD; iii) mandat arkëtimi nr. \*\*, datë \*\*.12.2001, për shumën 4.755 USD; iv) mandat arkëtimi nr. \*\*, datë \*\*.2.2001, për shumën 6.000 USD; dhe v) mandat arkëtimi nr. \*\*, datë \*\*.4.2001, për shumën 652 USD.

<sup>28</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f. 16).

<sup>29</sup> Vërtetuar me mandatin e Bankës \*\*\*\*, datë \*\*.12.2019.

<sup>30</sup> Referohuni vendimit të KPA-së (JR) nr. 8/2019, KPA (JR) nr. 15/2021, nr. 23/2020 (JR), datë 25.9.2020, prg. 25.4.

<sup>31</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot. datë \*\*.12.2019, lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Fier.

bankar apo në ndonjë formë tjetër të parashikuar në legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, deklaratat noteriale të vëllezërve të saj<sup>32</sup>, paraqitur nga subjekti në Komision për të provuar të ardhurat nga qiraja të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, referojnë në mënyrë kontradiktore shlyerjen e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara në vitet 1996-2001. Këto deklaratat noteriale rezultojnë se datojnë pas dorëzimit të D-Vett., janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti mbeten në nivelin deklarativ, nuk mund të konfirmojnë të vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to kanë ndodhur realisht.

4.6 Në përfundim të analizës së provave/akteve në dosje të Komisionit për pasurinë “Apartament 66 m<sup>2</sup>”, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti në lidhje me këtë pasuri ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

## **5. Pasuria nr. 4, “Dy garazhe me sipërfaqe 14 m<sup>2</sup>”, secili, ndodhur në adresën rruga “\*\*\* \*\*”, Tiranë**

5.1 Në D-Vett., bashkëshorti i subjektit deklaron si pasuri veçmas të regjistruara në emrin e tij: Dy garazhe me sipërfaqe 14 m<sup>2</sup> secili, ndodhur në rrugën “\*\*\* \*\*”, Tiranë. Blerë me kontratë shitje nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë \*\*.11.2013, nga \*\*\* Bank sh.a., çmimi i blerjes 1.300.000 lekë. Pjesa takuese:100%. Burimi i krijimit të pasurisë: (i) shuma prej 1.000.000 lekë, janë të ardhura të realizuara nga shitja e 10% të aksioneve të bashkëshortit në shoqërinë “\*\*\* \*\*” sh. a. (shumë të cilën e kemi pasur në *cash*); dhe (ii) shuma prej 300.000 lekë, kursime nga paga.

5.2 Në DV-2013, as subjekti i rivlerësimit dhe as bashkëshorti, nuk i kanë deklaruar këto pasuri.

5.3 Lidhur me burimin e deklaruar: (i) **Mbi shumën 1.000.000 lekë, përfituar nga shitja e 10% të aksioneve të bashkëshortit në shoqërinë “\*\*\* \*\*” sh. a.:**

5.3.1 Në D-Vett., bashkëshorti i subjektit deklaron: Të ardhura të krijuara nga shitja e 10% të aksioneve të zotëruara në shoqërinë “\*\*\* \*\*” sh. a., Tiranë, sipas kontratës së shitjes së aksioneve, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.3.2009, çmimi i shitjes 2.000.000 lekë. 10% e aksioneve të shoqërisë “\*\*\* \*\*” sh. a. janë blerë në datën \*\*.8.2006, në shumën 3.300.000 lekë, sipas deklaratës për shitje aksionesh nr. \*\*\*, datë \*\*.8.2006.

5.3.2 Në DV-2009, subjekti deklaron: Shitje e 10% të aksioneve të biznesit “\*\*\* \*\*” sh. a. (me objekt lojëra fati), në shumën 2.000.000 lekë. Ndërsa bashkëshorti ka deklaruar: “*Ndryshim në depozitë, shtesa të depozitës në Bankën \*\*\* (monedha USD) të siguruar nga shitja e aksioneve të “\*\*\* \*\*” sh. a., vlera 21.000 USD, pjesa takuese 100%*”.

5.3.3. Në DV-2010, bashkëshorti i subjektit deklaron: “*...ndryshim në depozitë, tërheqje totale e depozitës në Banka \*\*\*, e siguruar nga shitja e 10% e aksioneve*<sup>33</sup>, *1.000.000 lekë për shlyerjen e detyrimit ndaj vëllait dhe 1.000.000 lekë të dhëna hua*”. Në lidhje me huan, në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit, datë 17.2.2020, subjekti ka deklaruar se: “*...këtë hua z.*

<sup>32</sup> Deklaratë noteriale e z. \*\*\*.\*\*\*, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.12.2019, dhe deklaratë e thjeshtë, datë \*\*.11.2019, e \*\*\*.\*\*\*.

<sup>33</sup> Rezulton se me kontratën shitje aksionesh të shoqërisë “\*\*\* \*\*” sh. a., me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.3.2009, bashkëshorti i subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*, i ka shitur z. \*\*\*.\*\*\* 10% të aksioneve që gëzojnë në shoqëri, me vlerë 2.000.000 lekë, shumë e likuiduar në zyrën noteriale.

\*\*\*.\*\*\* ia ka dhënë vajzës, shtetases \*\*\*.\*\*\*, e cila kërkonte që të aplikonte për studime jashtë vendit. Kjo shumë është dhënë rreth muajit korrik-gusht 2010 dhe është kthyer në janar të vitit 2011. Bashkëshorti ka qenë i bindur se ka qenë brenda vitit dhe nuk ka pasur nevojë për ta shënuar kthimin e shumës... Nuk rezulton që bashkëshorti im të ketë bërë depozita të kësaj shume pas vitit 2010, moment që u tërhoq, dhe as të ketë investuar atë në blerjen e ndonjë pasurie. ... z. \*\*\* kishte idenë se, për sa kohë e kishte deklaruar të tërhequr nga banka dhe dhënë hua, fakti i kthimit të huas nuk ndikonte në deklaram, pasi ato ishin gjendje cash...”.

5.3.4. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se:<sup>34</sup> “[...] subjekti nuk ka qenë i saktë në deklaramin e gjendjes cash ndër vite, pasi ajo nuk ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë (e cila ka burim të ligjshëm), por ndërkohë në D-Vett. ajo ka deklaruar saktësisht se shuma prej 1.000.000 lekë ka shërbyer si burim për blerjen e garazheve. Mosdeklarimi i kthimit të shumës 1.000.000 lekë është një pasaktësi e subjektit në deklaramat periodike, por jo në D-Vett., për rrjedhojë, Komisioni pas shpjegimeve të dhëna të subjektit, si dhe mbështetur në analizën e mësipërme, do të përfshijë këtë shumë në analizën financiare të vitit 2013, duke e kthyer gjendjen e subjektit për këtë vit, pozitive [...].

5.4 Lidhur me burimin e deklaruar: **(ii) 300.000 lekë kursime nga paga**, Komisioneri Publik, referuar gjendjes së akteve në dosje, vlerëson se lidhur me këtë burim, nuk konstatohen problematika.

5.4.1 Komisioneri Publik, lidhur me burimet e deklarama të krijimit të kësaj pasurie nga subjekti dhe personi i lidhur me të, ndan vlerësim të ndryshëm me Komisionin për sa i përket burimit të parë (i), për sa trajtojmë në vijim:

5.4.2 Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9049/2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>35</sup>, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin të deklaramojnë saktësisht dhe plotësisht ndryshimet në pasuri, detyrimet etj. Në funksion të kontrollit të pasurisë, kursimet në cash jashtë sistemit bankar duhet të përlllogariten sipas deklarameve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaramat e interesave private sipas viteve përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

5.5 Komisioneri Publik vlerëson se, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003 kthimin e huas në vitin 2011 dhe posedimin e cash-it në këtë vit dhe, si rrjedhojë, nuk justifikohet me të ardhura nga burime të ligjshme shuma e depozituar pranë \*\*\* Bank në datën \*\*.11.2013, përdorur për blerjen e këtyre pasurive.

## 6 Pasuria nr. 5, Autoveturë “Mercedes Benz”, modeli “B 180”

6.1 Në D-Vett. dhe DV-2014, bashkëshorti i subjektit deklaramon si pasuri veçmas të regjistruara në emrin e tij: Automjet “Mercedes Benz”, modeli “B 180”, vit prodhimi 2010, CDI, blerë në datën \*\*.6.2014, pjesa takuese 100%, për vlerën 6.557 euro. Burimi i krijimit: (i) të ardhura nga paga;

<sup>34</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f.18).

<sup>35</sup> Vendimet e Kolegjit dhe (JR) nr. 27/2020 dhe (JR) nr. 13/2021.

dhe (ii) huaja prej 5.000 euro, marrë babait të subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*, nga vetë subjekti (shlyer totalisht gjatë vitit 2015, me të ardhurat familjare vjetore).

6.2 Mbi burimin e deklaruar: (i) Të ardhura nga paga, Komisionit, nga analiza financiare për periudhën \*\*.1.2014 – \*\*.6.2014, i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

6.3 Mbi burimin e deklaruar: (ii) Hua në shumën 5.000 euro nga babai, z. \*\*\*.\*\*\*, deklaruar nga subjekti në DV-2014, në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”: “Hua marrë nga i paralinduri, babai \*\*\*.\*\*\*, me kontratë huaje përdorur për blerjen e autoveturës në qershor 2014, pa interes, pa afat kthimi, shuma 5.000 euro”. Subjekti ka depozituar pranë Komisionit kontratë huadhënie, nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*.11.2014, ku z. \*\*\*.\*\*\* i ka dhënë hua subjektit shumën 5.000 euro, në datën \*\*.6.2014.

6.3.1 Komisioni e ka konsideruar babain e subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*, si person tjetër të lidhur<sup>36</sup> dhe ka hetuar lidhur me të ardhurat e realizuara prej tij. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur akte si provë shkresore për të provuar burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur për të mbuluar huan në shumën 5.000 euro<sup>37</sup>.

6.3.2 Komisioni, marrë në konsideratë provat dhe shpjegimet e subjektit, ka vlerësuar se<sup>38</sup>: [...] Siç rezulton nga dokumentacioni i depozituar, por edhe nga analiza financiare më poshtë, babai i saj ka pasur aftësi huadhënëse në shumën 5.000 euro [...].

6.4 Komisioneri Publik, lidhur me burimet e deklaruara të krijimit të kësaj pasurie nga subjekti dhe personi i lidhur me të, ndan vlerësim të ndryshëm me Komisionin për sa i përket burimit të dytë (ii), për sa trajtojmë në vijim:

6.4.1 Rezulton se Komisioni ka përfshirë në analizën e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, edhe shumën prej 5.841.438 lekë, në zërin: *Të ardhura nga ulla*, për periudhën 2006- \*\*.6.2014. Për këto të ardhura, siç kemi argumentuar më sipër, nuk rezulton të jetë provuar ligjshmëria e tyre në përputhje të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

6.5 Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti, referuar nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës nuk provoi me dokumentacion ligjor justifikues burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait për huan e deklaruar dhe, rrjedhimisht, rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë nr. 5.

<sup>36</sup> Bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>37</sup> i) Kontratë, datë \*\*.3.2006, për shitje trualli me sip. 682 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Fier, në vlerën 150.000 lekë; ii) Kontratë, datë \*\*.4.2008, për shitje trualli me sip. 1507 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Fier, në vlerën 1.478.367 lekë; iii) Kontratë, datë \*\*.1.2009, për shitje trualli me sip. 540 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Fier, në vlerën 529.740 lekë; iv) Vërtetim ISSH, Drejtoria Rajonale Fier, nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2019, për pension pleqërie, përfituar nga z. \*\*\*.\*\*\*, për periudhën 2004-2012; v) Vërtetim, lëshuar nga ISSH, Drejtoria Rajonale Fier, nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2019, për pension pleqërie, përfituar nga z. \*\*\*.\*\*\*, për periudhën 2013-2019; vi) Deklaratë e thjeshtë, pa datë, e shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe disa mandatpagesa; vii) Raport vlerësimi nga vlerësuesi \*\*\*.\*\*\*, e datës \*\*.12.2019, për z. \*\*\*.\*\*\*.

<sup>38</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f. 20).

**7 Pasuria nr. 6, Autoveturë “Mercedes Benz”, modeli “ML 270” CDI, blerë në datën \*\*.9.2007 dhe shitur në datën \*\*.12.2016**

7.1 Në D-Vett. deklarohen: *Të ardhura të krijuara nga shitja e automjetit “Autoveturë Benz Mercedes, ML 270”, në shumën 900.000 lekë, vërtetuar sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.12.2016.*

7.2 Në DV-2007 deklarohet: *“Blerje automjeti tip Benz-270, në shumën 15.000 euro. Burimi i krijimit: (i) të ardhura nga shitja e mjetit Benz-190, në vlerën 4.000 USD, blerë më parë për vlerën 6.000 USD; (ii) lekët e depozituara në bankë të tërhequra nga llogaria në USD (2006); dhe (iii) dhe kursime të vitit 2007”.*

7.3 Lidhur me burimin e deklaruar: (i) **Të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm Benz-190, në vlerën 4.000 USD**, subjekti gjatë hetimit administrativ nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar të ardhurat nga shitja e këtij automjeti, shumë të cilën Komisioni, fillimisht, nuk e ka përfshirë në analizën financiare të burimeve të ligjshme të blerjes së kësaj pasurie, në shumën 4.000 USD.

7.4 Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit, Komisioni ka vlerësuar se subjekti:<sup>39</sup> [...] *ka bërë të gjitha përpjekjet, por siç rezulton nga përgjigjja e DRSHTRR-së Tiranë, dosja e mjetit nuk gjendet, në këto kushte, subjekti është në kushtet e pamundësisë ... për të siguruar dokumentacion provues .... dhe në vijim ka konkluduar se ... shuma 4.000 USD do të përfshihet në analizë financiare... pasi shpjegimet e subjektit, të mbështetura në prova, krijojnë bindjen se ka pasur mundësi financiare për këtë veprim [...].*

7.5 Lidhur me burimin e deklaruar: (ii) **Lekët e depozituara në bankë, të tërhequra nga llogaria në USD, në vitin 2006**, sikundër trajtuar gjerësisht në ankim, Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet e subjektit, në përfundim ka arsyetuar se:<sup>40</sup> [...] *bashkëshorti i subjektit, pasi ka këmbyer shumën 18.000 USD në euro, e ka tërhequr në datën \*\*.10.2005 dhe, në këtë moment, subjekti nuk ka qenë ende në kushtet e bashkëjetesës/martesës ligjore me zotin \*\*\*.\*\*\* [...].*

7.6 Komisioneri Publik, për sa më sipër, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni për sa argumentuar si vijon:

7.6.1 Lidhur me burimin e deklaruar: (i) *Të ardhura nga shitja e automjetit të mëparshëm, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se vlera e blerjes së këtij automjeti në DV-2005 deklarohet 600 USD, ndërsa në DV-2007 (vit në të cilin është shitur) vlera e blerjes së automjetit deklarohet 6.000 USD. Nisur nga mospërputhjet në deklarin e çmimit të blerjes së automjetit Benz-190, në vlerësimin e Komisionerit Publik, në mungesë të kontratës së shitblerjes, mbetet i paprovuar çmimi real i blerjes së tij, për të verifikuar nëse rezulton fitim nga transaksioni i shitjes së automjetit, fitim mbi të cilin do të duhej të aplikohet tatimi sipas*

<sup>39</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f. 26).

<sup>40</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f. 26).

ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar). Si rrjedhim, ky burim nuk do të duhej të përfshihej në analizën financiare të Komisionit.

7.6.2 *Lidhur me burimin e deklaruar: (ii) Lekë të depozituara në bankë, të tërhequra nga llogaria në USD, në vitin 2006*, deklarimet e subjektit lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në procesverbalet e mbajtur në ILDKPKI dhe shpjegimet gjatë hetimit administrativ, janë kontradiktore. Rezulton se në *DV-2005* dhe *DV-2006*, subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar posedim të kursimeve në *cash* në banesë, sipas detyrimit të parashikuar në ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Komisioneri Publik, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>41</sup>, çmon se pretendimet e subjektit mbi disponimin e këtyre kursimeve, nuk janë bindëse dhe këto shuma nuk mund të konsiderohen si burime të ligjshme për blerjen e pasurisë nr. 6., pasi në funksion të kontrollit të pasurisë, kursimet në *cash* jashtë sistemit bankar, duhet të përlllogariten sipas deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratat e interesave private sipas viteve përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

7.6.3 *Lidhur me burimin: Kursime të vitit 2007* rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën \*\*.1.2007- \*\*.9.2007, janë në shumën 1.005.116 lekë<sup>42</sup>, që nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë<sup>43</sup>, ndryshimet në likuiditetet e depozituara në sistemin bankar<sup>44</sup> dhe blerjen e pasurisë *automjet*.

7.7 Në përfundim për këtë pasuri, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e saj.

## 8 Çështje të tjera

### 8.1 Mbi transaksionin 12.000 euro, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit

8.1.1 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se në datën \*\*.7.2007, shtetasi \*\*\*,\*\*\* ka depozituar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, pranë \*\*\*, në *cash*, shumën 12.000 euro, e cila është tërhequr po *cash* nga bashkëshorti i subjektit, në datën \*\*.9.2007.

8.1.2 Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, pas kalimit të barrës së provës, lidhur me pamundësinë financiare të konstatuar nga Komisioni për krijimin e depozitës në shumën 12.000 euro, dhe provat të paraqitura nga subjekti, Komisioni ka vlerësuar se:<sup>45</sup> [...] *shpjegimet e subjektit, të mbështetura në prova, krijojnë bindjen se subjekti ka pasur mundësi financiare për këtë veprim [...].*

<sup>41</sup> Vendimet e Kolegjit dhe (JR) nr. 27/2020 dhe (JR) nr. 13/2021.

<sup>42</sup> Të ardhurat përfshijnë të ardhurat familjare nga paga dhe dëmshpërblimet janar-shtator 2007 sipas kreditimeve në llogaritë bankare dhe të ardhurat nga interesat bankare.

<sup>43</sup> Shpenzimet e jetesës për 3 persona deri në shtator 2007 sipas ILDKPKI, bazuar në të dhënat e INSTAT-it, shpenzimet për udhëtime deri në shtator 2007.

<sup>44</sup> Sipas konfirmimeve të bankave të nivelit të dytë për likuiditetet deri në shtator 2007, në llogaritë e subjektit dhe të personave të lidhur me të.

<sup>45</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f. 27).

8.1.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzioni i mësipërm i Komisionit nuk përputhet me gjendjen që janë aktet, pasi nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, që konsiderohen si provë, në kuptim të nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të kenë deklaruar kursime në *cash* në vitet 2005 dhe 2006.

8.1.4 Komisioneri Publik, përkundër pretendimit të subjektit se nuk e kemi kuptuar se kemi pasur detyrimin të deklarojmë edhe gjendjen e *cash*-it në banesë, çmon se, referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, zyrtarët deklarues detyrohen të deklarojnë kursimet në *cash* jashtë sistemit bankar, gjendje, deri më datë 31 dhjetor të vitit paraardhës, në deklaratën e interesave private periodike. Subjekti duhet të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre, sipas formularit të deklarimit të pasurisë, i miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

8.1.5 Në kuptim sa më sipër dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit,<sup>46</sup> Komisioneri Publik vlerëson se, në funksion të kontrollit të pasurisë, kursimet në *cash* jashtë sistemit bankar, duhet të përlllogariten sipas deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, në deklaratat e interesave private sipas viteve përkatëse, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

8.1.6 Në konkluzion të sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe nuk mbulon me burime të ligjshme depozitën prej 12.000 euro, në vitin 2007.

## **8.2 Mbi transaksionin 10.000 euro, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*.**

8.2.1 Gjatë hetimit administrativ, nga lëvizjet e llogarisë në euro, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*.\*\*\*, pranë \*\*\* Bank, ka rezultuar se, në datën \*\*/3.2002, është kryer transaksioni: depozitim në *cash* në shumën 10.000 euro, me përshkrimin: “*Depozitim në arkë...nga Irena Maneku*”<sup>47</sup>.

8.2.2 Pas shpjegimeve të subjektit, në përgjigjet e Pyetësorit nr. 2, Komisioni ka vlerësuar se:<sup>48</sup> [...] *lidhur me këtë transaksion, nuk ka paqartësi apo dyshime dhe kjo depozitë e ka origjinën e saj gjatë kohës së regjimit të parë martesor të z. \*\*\* [...].*

8.2.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpjegimet e subjektit: *se ...nuk kam pasur asnjë lidhje me këtë veprim bankar, si dhe nuk ka pasur pronësinë mbi asnjë pjesë të kësaj shume, mbetën thjesht në nivel deklarativ dhe të pambështetura në asnjë burim prove nga ato që parashikon neni 49 i ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, i vetmi transaksion bankar i provuar është kreditimi i një vlerë prej 10.000 euro, nga subjekti i rivlerësimit, në llogarinë e bashkëshortit të saj të ardhshëm, referuar lëvizjeve të llogarive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.*

## **8.3 Mbi huat e dhëna nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit**

8.3.1 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka ardhur në dijëni për dy hua të dhëna shtetasit z. \*\*\*.\*\*\* nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*.\*\*\*<sup>49</sup>, konkretisht: (i) Me kontratë huaje

<sup>46</sup> Vendimet e Kolegjit (JR) nr. 27/2020 dhe (JR) nr. 13/2021.

<sup>47</sup> Sipas dokumentacionit bankar të \*\*\* Bank, përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*/11.2019.

<sup>48</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f. 22).

<sup>49</sup> Konfirmuar dhe nga DPPP me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*/5.2017 drejtuar ILDKPKI.

nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë \*\*.11.2008, rezulton se z. \*\*\*.\*\*\* i ka dhënë hua z. \*\*\*.\*\*\*, për një periudhë 2 muaj e 4 ditë (kthimi është parashikuar në datën \*\*.1.2009), shumën 16.000 USD, me interes; (ii) Me kontratë huaje nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.4.2012, z. \*\*\*.\*\*\* i ka dhënë hua z. \*\*\*.\*\*\*, për një periudhë 3-mujore, shumën 34.500 USD.

8.3.2 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit mbi këto marrëdhënie, pasi nuk rezultojnë të deklaruara në deklaratat e interesave periodike vjetore të viteve respektive.

8.3.3 Pas shpjegimeve të subjektit në përgjigjet e Pyetësorit nr.1 dhe provat e paraqitura, Komisioni ka vlerësuar se:<sup>50</sup> [...] *Në lidhje me këtë hua (34.500 USD), subjekti ka depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të bashkëshortit të saj, të cilat kanë pasur si burim huan e marrë nga z. \*\*\*.\*\*\* Nga hetimi rezultoi se z. \*\*\*.\*\*\* kishte të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje... Në lidhje me këtë hua (16.000 USD), subjekti ka depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të bashkëshortit të saj, të cilat kanë pasur si burim huan e marrë nga z. \*\*\*.\*\*\* Nga hetimi rezultoi se z. \*\*\*.\*\*\* kishte të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje.*

8.3.4 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, për dy huat e analizuar më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar as mënyrat e marrjes së shumave nga bashkëshorti, \*\*\*.\*\*\* te huadhënësit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, dhe as kthimin e tyre, duke pamundësuar kontrollin financiar dhe ligjor të këtyre marrëdhënieve, përkundër detyrimit që ligji i njej.

8.3.5 Deklaratat noteriale, të paraqitura nga subjekti, rezultojnë se datojnë pas dorëzimit të D-Vett., janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e subjektit mbeten në nivelin deklarativ, nuk mund të konfirmojnë të vetme, dhe jo në harmoni me prova të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to kanë ndodhur realisht.

## **II. Kërkimi i ankimit**

**9** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

**10** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**11** Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

---

<sup>50</sup> Referohuni vendimit të KPK-së (f. 27).



**12** Bazuar në nenin Ç, D, DH, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, nenet 4 dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016;

**13** Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 241, datë 26.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**